



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:261764
Datë: 11.11.2020
Numri i dokumentit: 01263991

A.nr.888/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit G. shpk nga F.kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: rivlerësim doganor, në seancën publike rtimit kryesor të mbajtur me datë 10.11.2020, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET Kërkesëpadia e paditësit G. shpk nga F., si e pa bazuar.

Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.01.3.2.2/109 datës 13.03.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit R3637/27.01.2018 të ZBD Prishtinë.

Paditësi G. shpk nga F., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 23.04.2018, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të ndryshohet aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr.01.3.2.2/109 datës 13.03.2018, dhe të obligohet e paditura që mjetet monetare në shumë të paguara në emër të detyrimeve doganore ti kthehen paditësit.

Paditësi në padinë e tij dhe përmes të autorizuarit në seancën publike deklaroi: me anë të Deklaratës doganore R3637/27.01.2018 ZBD Prishtinë, janë deklaruar për doganim mallra të ndryshme në gjithsejtë 20 emërtime sipas faturës dhe deklaratës doganore. Me rastin e deklarimit për doganim të mallrave paditësi ka poseduar dhe prezantuar të gjitha dokumentet obligative për deklarimin e mallit dhe të tjera të nevojshme për ta bërë bindëse vlerën e transaksionit dhe vlerën reale të mallit. Dokumentet e mallit nuk janë marrë parasysh nga e paditura të cilët kanë kontestuar vlerën e mallit dhe e kanë rivlerësuar në bazë të metodës së 6 të vlerësimit. E paditura nuk ka poseduar asnjë provë materiale që do të vërtetonte pretendimin e saj se kinse paditësi ka paguar me tepër në emër të mallit që do të dëshmonte se nuk ka paguar vlerën e transaksionit të mallit, në mënyrë që pastaj të kalohet në metodën e parë të vlerësimit dhe të përcaktohet baza doganore në bazë të metodave tjera. Ekziston shkelje e dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave nga ZBD Prishtinë, nga shkak se nuk është zbatuar në mënyrë adekuate dispozita ligjore përkatësisht neni 33 i tij. ZBD Prishtinë nuk është dashur të kalojë në metodat e tjera të vlerësimit pa kaluar nëpër metodat paraprake dhe pa ia arsyetuar ato. Ekziston shkelja e U.A. 11/2009 përkatësisht dispozitat nga Kapitulli 1 dhe neni 123 të tij, pasi që e paditura pa dhënë asnjë sqarim dhe pa e bërë verifikimin e tyre nuk bëjnë pranimin e dokumenteve të transaksionit. Paditësi me rastin e paraqitjes së mallit, për zhdoganim me anë të DUD-it kontestues, e po ashtu edhe në procedurën e ankesës, i ka bashkangjitur lëndës dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit, sikurse janë, fatura dhe urdhërpagesa bankare në emër të saj, pagesa është bërë me valutën Euro, në kundërvlerë të çmimit të faturës

që është lëshuar në Dollarë, me kursin e valutës në ditën e pagesës siq i është bashkangjitur urdhërpagesës bankare në shkresat e lëndës. E paditura ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit në fazë të procedurës ankimore duke pranuar çmimin e transaksionit për disa emërtime të DUD kontestues mirëpo ka refuzuar pranimin e çmimit të transaksionit për disa emërtime të tjera edhe pse bëhet fjalë për dokumentet e njëjta që kanë shoqëruar deklaratën doganore. Me rastin refuzimit të pranimit të çmimit të transaksionit për disa emërtime e paditura është mbështetur në çmime referente të mallrave të ngjashme, mirëpo konsiderojmë se nuk është bërë një analizë e sakt krahasuese e llojit të mallit, modeleve, sasisë së kontraktuar dhe parametrave tjerë tregtar që mund të ndikojnë në çmimin e mallit. Si pasojë e rivlerësimit paditësi kishte paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore shumë prej 4,597.64 Euro, ndërsa e paditura i ka kthyer paditësit shumë prej 1,670.61 Euro, prandaj kanë mbetur të paguar më tepër edhe mjetet në vlerë prej 2,927.03 Euro, është vlerë e precizuar e kërkesëpadisë.

E paditura në përgjigje në padi dt.15.06.2020 dhe përmes të autorizuarit në seancën publike deklaroi: e kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar i propozoj gjykatës që të njëjtën ta refuzoi si të pa bazuar, dhe të lë në fuqi Vendimin e Doganës së Kosovës, si të ligjshëm dhe të drejtë. Dogana e Kosovës në mënyrë të drejtë ka vendosur çështjen kontestuese për arsye se gjatë marrjes së aktvendimit janë shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe është konstatuar se Sektori i pranimit qëndror sa i përket dy emërtimeve të DUD-it kontestues nuk ka vepruar drejtë gjatë vlerësimit të mallit, për arsye se siq është cekur në arsyetim të aktvendimit kontestues në emërtimin e 17 të DUD-it kontestues, Sektori për shqyrtimin e vendimeve ka caktuar vlerë të re doganore, ku janë marrë për bazë të dhënat e disponueshme, të dhënat nga dosja e vlerave, që këto të dhëna janë marrë të dhëna të besueshme dhe reale. Që janë marrë bazuar në zhdoganimet e mëhershme sipas vlerës së transaksionet nga i njëjti shtet i origjinës dhe eksportuesi i njëjtë, ku është vlerë më e ulët sesa vlera e përcaktuar nga zyrtarët e pranimit dhe më e lartë sesa vlera e deklaruar nga subjekti, që do të thotë se në këtë emërtim është përcaktuar vlerë reale e mallit. Ndërsa sa i përket emërtimit të 18, Sektori i rishqyrtimeve pas analizimit të dhënave të disponueshme, nga dosja e vlerave ka konstatuar se vlera e deklaruar nga subjekti është po thuajse e njëjtë dhe në këtë rast ka pranuar vlerën e transaksionit. Ndërsa emërtimet e tjera kanë mbetur ashtu siç janë vlerësuar nga sektori i pranimit qëndror. Andaj, pas marrjes së vendimit të këto dy emërtimeve Dogana e Kosovës, ka aprovuar pjesërisht kërkesën e subjektit, duke kthyer mjetet në vlerën e cekur në aktvendim. Vlen të theksohet se në rastin konkret subjekti në procedurë as në fazën e zhdoganimit e as në fazën e ankimit nuk ka arritur të paraqes të gjitha dokumentet për të dëshmuar vlerën reale të mallit, për arsye se ka munguar kontrata e shitblerjes e lidhur në mes eksportuesit dhe importuesit, në të cilën do të kontraktohet çmimi i mallit, pastaj kushtet e dërgesës etj. Po ashtu ka munguar deklarata eksportuese në të cilën duhet të jenë të cekura detajet e mallit duke përfshirë numrin e faturës, vlerën e mallit, peshën etj, që do të thotë se në rastin konkret vendimi i atakuar është marrë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. I propozojmë gjykatës që të merr Aktgjykim me të cilin do të refuzonte në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, dhe të lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm dhe të drejtë

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 10.11.2020 administroi këto prova: përgjigja në padi e dt. 15.06.2020 nga Dogana e Kosovës, aktvendimi 01.3.2.2/109, dt.13.03.2018 i Doganës së Kosovës, Deklaratat Doganore, fatura nr.YBIEGR1602017-7 dt.01.12.2017, urdhërpagesa bankare, fatura e shpenzimeve të transportit, Kontrata e shitblerjes, Çertifikata e regjistrimit nr. i biznesit 71328309, Çertifikata-deklaruese e TVSH-së, informata mbi biznesin e dt.20.10.2016, Kërkesa e dt.28.02.2018, fletë dërgesa e Korrierit dt.26.02.2018, Urdhër-Kthimi i Mjeteve dt.26.03.2018, ankesa e paditësit me nr.prot.109/27.02.2018, Deklarata e të dhënave në lidhje me vlerën doganore D.V.1 dt.01.12.2017, fatura tatimore, e dt.26.01.2018, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave dt.27.01.2018.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësit për arsye se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë. Sektori i pranimit qëndror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar

në metodën e 6 të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës mirëpo nuk ak vepruar drejt kur gjatë rivlerësimit në emërtimin 17 dhe 18 ka përcaktuar vlerë të re doganore e që nuk dihet saktë se ku janë bazuar gjatë përcaktimit të vlerës, kurse pa analizës që është bërë janë marrë et dhënat e disponueshme nga të dhënat nga dosja e vlerave e që merren si të dhëna të besueshme dhe reale, pasi që për këtë mall ka pasur në dispozicion të dhëna nga zhdoganimet e mëhershme nga i njëjti shtet eksportues dhe i origjinës. Dokumentacioni i mallit është vlerësuar si provë e pamjaftueshme pasi që mungon kontrata e shitblerjes, mungon deklarata eksportuese.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se mallin lëndor e kanë përcjell të gjitha dokumentet e nevojshme të cilat kërkohen për vendosje të mallit në qarkullim të lirë, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Nga provat e lëndës gjykata nuk ka mund të vërtetoj vlerën reale të paguar për mallin lëndor nga fatura pa informata të mjaftueshme dhe konfirmim të pagesës nga ana e eksportuesit-shitësit, prandaj edhe gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e papranueshme, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor e që në këtë rast është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar.

Si fakte vendimtare që kanë ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor ka qenë se e paditura Dogana e Kosovës është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe Akcizave respektivisht në bazë të vlerës së transaksionit të mallrave të ngjashme. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli doganor nga dosja e vlerave përkatësisht sipas zhdoganimeve të mëhershme është provë e bazuar për tu rivlerësuar malli lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, (dosja e vlerave, DUD-at R73136/23.12.2017, R67863/02.12.2017, R57468/18.10.2017), prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor sipas këtyre mallrave të ngjashme.

Gjykata konsideron se në këtë rast paditësi nuk ka arrit të dëshmoj vlerën e transaksionit të paguar për mallin lëndor, kështu që nuk mund të pranohen pretendimet se paditësi ka prezantuar të gjitha dokumentet e nevojshme për tu pranuar vlera mallit lëndor konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Nga provat e administruara gjykata nuk ka gjetur fakte të bazuara që argumentojnë se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale të mallit lëndor sipas faturës përcjellëse të mallit, prandaj gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësit.

Nga kjo gjendje gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor.

Në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi nr.01.3.2.2/109 datës 13.03.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Numri i lëndës: 2019:261764
Datë: 11.11.2020
Numri i dokumentit: 01263991

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.888/18 datë 10.11.2020

G j y q t a r i,
Krenar Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.